



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:030141

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05725771

P.nr. 352/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, në përbërje me gjyqtarin e vetëm gjykues Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit, G.B., për shkak se ka kryer veprën penale, “Vjedhja” nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 408//22 e datës: 10.02.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë: 29.04.2024, ku morën pjesë, Prokurori i Shteti Rrahim Podvorica, i akuzuari G.B., me datë 02.05.2024, mori dhe shpalli, kurse me datë: 10.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G.B., nga i ati H i lindur me 13.10.1976, me adresë të vendbanimit në rr. “---” në Prizren nr.--, i pa punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike me social, me numër personal “letërnjoftimi”, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I pandehuri, G.B. me datë 16.11.2021 rreth orës 13:20, në rrugën “Ibrahim Lutfiu” në Prishtinë me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshëm, e vetit t’i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm pasi e kishte hasur në rrugë nga xhepi i pantollonit ja kishte vjedhur telefonin Iphone X të dëmtuarit- të miturit R.I. kishin vjedhur në vlerë prej 300€ me ç ‘rast të dëmtuarit, i kishte shkaktuar dëm material si është përshkruar më lartë.

- Me këtë ka kryer veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70 dhe 313 par. 1, të KPRK-së dhe neneve 242 par.2, 358, 364, dhe 365, të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

DENIM ME BURG DHE DENIM ME GJOBË

- I. I akuzuari G.B., dënohet me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Të akuzuarit, i shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 300 (treqind) Euro, të cilën gjobë është i obliguar të paguan në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
- III. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgim duke e llogaritur, 20 (njëzet) Euro me 1 (një) ditë burgim.

Andaj gjykata konform nenit 59 par.2 nen par.2.2, lidhur me nenin 61 të KPPRK-së, ndaj të pandehurit i shqipton:

DENIM PLOTËSUES

- I akuzuari G.B, urdhërohet për kompensimin e humbjes apo dëmit në shumën prej 300 Euro (treqind) palës së dëmtuar F.I. , përfaqësues i palës së dëmtuar R.I. , të cilin kompensim është e obliguar të paguan në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.
- Ky aktgjykim shërben si dokument përmbartues, konform Ligjit për Procedurën Përmbartimore në Republikën e Kosovës.
- Obligohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale deri në shumën e plotë të tyre, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 (njëzet) Euro, në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzet) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

Rrjedha e procedurës, Historiku:

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP/II.nr.408/22 e datës: 10.02.2022, kundër të akuzuarit, G.B., për shkak se ka kryer veprën penale, “Vjedhja” nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Kompetenca e gjykatës:

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrim të aktakuzës, ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore.

Sa i përket kompetencës territoriale, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë territoriale për të gjykuar një çështje juridiko-penale ka gjykata në territorin e së cilës është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, apo gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar pasojja. Në rastin konkret, vepra penale është kryer në rrugën “Ibrahim

Lutfiu” në Prishtinë, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konsideron se me qenë se për veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 par.1 të KPRK-së parashihet dënim me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, po ashtu meqenëse e njëjta vepra nuk është paraparë me nenin 22 të KPPRK-së, atëherë gjykata konstaton se departamenti i përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Shqyrtimi fillestar:

Gjykata pas analizimit dhe vlersimit të aktakuzës, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë: 29.04.2024, ku gjatë kësaj seance kanë qenë prezent Prokurori i Shtetit Rrahim Podvorica, i akuzuari G.B. , ku i akuzuari, pasi që i janë lexuar të drejtat e tij në harmoni me nenin 241 të Kodin e Procedurës Penale nga ana e gjykatës, ka theksuar se don që të deklarohet.

I akuzuari G.B., në seancën e shqyrtimit fillestar, pohon se donë të deklarohet dhe për këtë rast pranon se është fajtor ndihet i penduar dhe nuk do ta përsëris më.

Prokurori i Shtetit Rrahim Podvorica, lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë së të pandehurit pasi që konsideroj se është bërë konform nenit 242 të KPPRK-së.

Vlerësimi mbi pranimin e fajësisë:

Andaj gjykata me aktvendim pranoi, pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuzën dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 242 par.2 të KPPRK-së.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale:

Se i akuzuari G.B., me datë 16.11.2021 rreth orës 13:20, në rrugën “Ibrahim Lutfiu” në Prishtinë me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshëm, e vetit t’i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm pasi e kishte hasur në rrugë nga xhepi i pantollonit ja kishte vjedhur telefonin Iphone X të dëmtuarit- të miturit R.I., kishin vjedhur në vlerë prej 300€ me ç’rast të dëmtuarit, i kishte shkaktuar dëm material si është përshkruar më lartë. Gjykata nga deklarimi i të akuzuarit në shqyrtimin fillestar dhe pranimi i fajësisë nga ana e tij, si dhe deklarimi i prokurorit duke e pranuar pranimin e fajësisë, si dhe nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka konstatuar se janë përmbushur elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Shqiptimi i sanksionit penale:

Gjykata me rastin e matjes së dënimit mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti se i njëjti ka pranuar fajësinë, lidhur me veprën penale e cila i ngarkohet sipas aktakuzës së lartë cekur, gjykata këto i merr si rrethana lehtësuese, ndërsa si rrethanë rënduese gjeti se i njëjti ka kryer veprën penale të mashtrimit ndaj tani të dëmtuarit F.I. andaj të akuzuarit i shqiptohet dënimi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pasi që, i akuzuari e kishte vjedhur të dëmtuarin, me këtë rast tek i dëmtuari kishte shkaktuar dëm material, ashtu siç është përshkruar në aktakuzën e cila i vihet në barrë për veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së. Të akuzuarit i shqiptohet dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Qëllimi i shqiptimit të dënimit:

Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, si dhe në rehabilitimin e tij në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, po ashtu edhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Shqiptimi i dënimit plotësues:

Gjykata vlerëson se dënimi plotësues i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, ndërsa vendimi mbi urdhërimin e kompensimit të dëmit është bazuar në neni 61 par 1 dhe par.2 të KPRK-së, ku nga paragrafi.1 citohet se: “Kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale”. Ndërsa nga paragrafi 2, citohet se “Dëmshpërblimi përfshin vlerën e shpenzimeve që janë të barabarta me vlerën e çfarëdo pasurie të vjedhur, humbur, dëmtuar apo shkatërruar. Dëmshpërblimi do të urdhërohet gjithashtu edhe për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat viktimat i përjeton si rezultat i veprës penale dhe procedurave hetimore dhe gjyqësore lidhur me atë vepër”, andaj nga fakti se pala ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar, është vërtetuar se ka shkaktuar dëm palës së dëmtuar, pasi që një gjë të tillë nuk e ka kontestuar një dëm të tillë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale:

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1, dhe par.2 të KPRK-së. ku nga paragrafi .1citohet se: Kur gjykata e shpall të akuzuarin fajtor, me aktgjykim vendos se detyrohet t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale. Po ashtu, konform Ligjit 08/L0-109 nenit 36 par. 3. për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguaj shumën prej 20 euro në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Baza ligjore mbi të cilën u vendos sipas këtij aktgjykimi:

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70 dhe 313. par.1 të KPRK-së dhe neneve 242 par.2, 358, 364, 365, 452, 462, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.352/22, datë: 08.04.2024

Bashkëpunëtori profesional:
Asdren Selmani

Gjyqtari:
Sabit Sadikaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.